

Jeta në Zvicër

Studim: Të rinjtë dhe shëndeti në Zvicër

Sociologu Thomas Abel nga Universiteti i Bernës ka hulumtuar me ekipin e tij gjendjen shëndetësore të rreth 30 mijë të rinjve të moshës 18 deri në 21 vjeç.

E Hënë, 3 Shkurt 2014 - 8:57albinfo.ch



«Schweiz am Sonntag» ka publikuar rezultatet, ku vijnë në pah dallimet regjionale në Zvicër sa i përket shëndetit në mesin e të rinjve.

Kështu, më shumë se një e treta e të rinjve në Zvicër perëndimore nuk kanë treguar performancë të mirë fizike. Në Ticino kjo shifër është vetëm 16 për qind. Në pjesën italiane të Zvicrës më shumë se 34 për qind e të rinjve tymsin duhan dhe shumë më pak bëjnë sport në krahasim me moshatarët në Zvicrën gjermane.

Por, pirja e tepruar është e përhapur edhe në Zvicrën perëndimore. Përveç kësaj, studimi tregon se në këtë pjesë të Zvicrës të rinjtë e varfër kanë më pak shanse për një jetë të shëndetshme.

“Përveç shkollimit, origjina është një nga faktorët e fortë që ndikon në shëndetin e të rinjve”, thotë sociologu Abel. Veçanërisht qartë reflekton kjo në statusin shëndetësor të të rinjve. Gati 35 për qind e adoleshentëve me prindër të pakualifikuar janë me mbipeshë.

“Ne kemi nevojë për promovimin e ruajtjes së shëndetit, veçanërisht në mesin e të rinjve të rritur me arsim të ulët”, thonë studiuesit, transmeton Nordwestschweiz.

KUJDES ! TEKSTI YNË I KOPJUAR DO TË DENONCOHET DHE RAPORTOHET. PËRPOS NËSE...

Në të ardhmen, në qoftë se keni nevojë për të kryer një aktivitet, i cili kërkon lëvizje, mos mbani veshur pantallona të ngushta, sepse çmimi duket të jetë tepër i rëndë.

KUJDES ! TEKSTI YNË I KOPJUAR DO TË DENONCOHET DHE RAPORTOHET. PËRPOS NËSE...